



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 17 korrik 2023
Kodi i ZRRE-së:V_1748_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 pika 1.2 dhe paragrafi 7 nënpar. 7.2, Nenin 25 dhe Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafin 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 25/ 14 Korrik 2016,Prishtinë));
- Dispozitat e Nenit 22 paragrafi 7 dhe Neni 23 paragrafi 9, pikat 9.3, 9.13, 9.15 dhe 9.16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 26/ 21 Korrik 2016,Prishtinë);
- Dispozitat e Nenit 3, 4, 5, 6 dhe 7 të Rregullës Nr. 04/2020 për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për Kryerjen e Aktiviteteve të Ndërlidhura me Bashkimin e Tregut dhe Operimin e Tregut të Bashkuar;
- Dispozitat e Nenit 3.5 të Licencës së Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike të lëshuar KOSTT SH.A, me numër Licence: ZRRE/Li_16/17;
- Vendimin V_1332_2020 të datës 10.12.2020 për Arovim në Parim të kërkesës së OT/KOSTT SH.A për transferim e disa të drejtave dhe përgjegjësi, që kanë të bëjnë me organizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike një ditë para dhe brenda ditës, tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX sh.a.).
- Vendimin V_1637_2022 të datës 27.12.2022 për aprovimin e transferimit të të drejtave dhe detyrimeve për organizimin e tregut një ditë para, tregut ndërditor dhe kalkulimet e barazimit përfundimtar nga tek (ALPEX sh.a);
- Vendimin V_1638_2022 të datës 27.12.2022 për aprovimin e rregullave dhe procedurave (kushtet e përgjithshme, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimin dhe shlyerjes);
- Kërkesën/aplikacionin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A. për Emërimin e ALPEX SH.A., si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), nr. 329/23 të datës 21.06.2023;

në seancën e mbajtur me datë 17 korrik 2023, nxori këtë:



V E N D I M

- I. **APROVOHET** - kërkesa e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX sh.a.), dhe **PËRCAKTOHET** si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), për kryerjen e Aktiviteteve të Ndërlidhura me Bashkimin e Tregut të një ditë para dhe ndërditor dhe Operimin e Tregut të Bashkuar për territorin e Republikës së Kosovës.
- II. **DETYROHET** shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX sh.a.), që para funksionalizimit të NEMO-së, të dorëzoj Programin Ekonomik të vitit 2023 të ndryshuar dhe miratuar nga organet drejtuese të ALPEX-it.
- III. **OBLIGOHET** shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX sh.a.) që të dorëzoj arsyeshmëri të pranueshme për ndryshimin e numrit të stafit në raport me propozimin e parë të dorëzuar dhe ky ndryshim të dorëzohet para funksionalizimit të NEMO-së.
- IV. **OBLIGOHET** - shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX sh.a.) që në cilësinë e NEMO-së, të dërgojë ne ZRRE për miratim metodologjinë për përcaktimin tarifave dhe me pas në përputhje me këtë metodologji të kryej edhe aplikacionin për caktimin e tarifave.
- V. Emërimi i NEMO-së sipas Nenit 3 të Rregullës Nr. 04/2020 do të mbetet i vlefshëm deri në përfshirjen e Rregullores CACM në legjislacionin primar të Republikës së Kosovës e pastaj emërimi i NEMO-së do të do të konfirmohet në pajtim me Rregulloren CACM.

A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE) me datë 21.06.2023 nga shoqëria Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A. ka pranuar Kërkesën/ aplikacionin për emërimin e ALPEX SH.A., si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për kryerjen e Aktiviteteve të Ndërlidhura me Bashkimin e Tregut të një ditë para dhe ndërditor dhe Operimin e Tregut të Bashkuar për territorin e Republikës së Kosovës.
- o Shoqëria Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A. me rastin e aplikimit, ka plotësuar formularin sipas Shtojcës 1.a, për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve të renditura në Nenin 4 të Rregullës Nr. 04/2020 si dhe ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas Shtojcës 1.5 të Rregullës Nr. 04/2020.
- o ZRRE pas pranimit të kërkesës/aplikacionit për Emërimin e NEMO-së, ka caktuar një komision për vlerësimin e dosjes dhe dëshmime të bashkangjitura, ku ka vlerësuar dëshmitë përkatëse të kërkuara sipas Shtojcës 1.b, që kërkohen të plotësohen për të emëruar NEMO-në si monopol kombëtar për shërbimet e tregtimit të një-ditë-para dhe atij ndër-ditor.



- ZRRE ka vlerësuar dëshmitë e kërkuara sipas Nenit 4 të Rregullës për NEMO, ku sipas Shtojcës 1.a, aplikuesi ka paraqitur informatat e përgjithshme të subjektit juridik, informatat kontaktuese, deklaratë, nëse aplikuesi është duke aplikuar për Emërim si NEMO ALPEX sh.a, për bashkim të tregut një ditë para dhe ndërditor, deklarata nëse subjekti është aktiv si një monopol legal në një treg tjetër, deklaratë, nëse i gjithë ose një pjesë e aplikimit është konfidenciale, arsyet pse dhe cilat pjesë, si dhe nënshkrimin dhe deklaratën për saktësinë e informatave të dorëzuara.
- Po ashtu Sipas Shtojcës 1b, në lidhje me Interpretimin e Nenit 4 dhe dokumenteve mbështetëse të ndërlidhura që duhet të dorëzohen në përputhje me të, duke marr parasysh shembujt e praktikave më të mira nga Shtetet Anëtare të BE. Aplikuesi për përmbushjen e kritereve të përcaktuara në Nenin 4 par. 1 nënpar 1.1 ka deklaruar se ka dhe ka kontraktuar të gjitha burimet e nevojshme për operimin e përbashkët të tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda së njëjtës ditë, duke përfshirë burimet financiare, teknologjinë e informacionit, infrastrukturën teknike dhe procedurat operacionale që sigurojnë ushtrimin e funksioneve të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për plotësimin e kërkesave ligjore.
- Për përmbushjen e kërkesave ligjore të përcaktuara me Nenin 4 par. 1.2 Aplikuesi ka ofruar sqarime në lidhje me ofrimin e qasjen në informata sipas Nenit 5 të Rregullës, ku ka ofruar dëshmitë e nevojshme në lidhje me: strategjinë e komunikimit, përfshirë përshkrimin dhe dëshmitë se ku dhe si mund të qasen në informata pjesëmarrësit e tregut, procesin e publikimit të të dhënave dhe përshkrimin e planifikimit për raste emergjente dhe ka ofruar garanci në këto informata se do të jenë në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve të tregut.
- Për përmbushjen e kërkesave ligjore të përcaktuara me Nenin 4 par. 1.3 aplikuesi ofruar sqarime se do të operoj me kosto eficiente në lidhje me bashkimin e tregut të një ditë para dhe ndërditor dhe ka ofruar sqarime lidhur me kontabilitetin e brendshëm, dhe llogarit e ndara për funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (OTB), dhe aktivitetet tjera në mënyrë që të parandaloj ndër-subvencionimin eventual.
- Për përmbushjen e kërkesave ligjore të përcaktuara me Nenin 4 par. 1.4 ka ofruar sqarime dhe dëshmi të nevojshme duke përfshirë: informata në lidhje me bizneset e tjera mundshme të aplikuesit, deklaratë në lidhje me atë nëse aplikuesi është duke bashkëpunuar me palët tjera, në përmbledhje të plotë të të gjitha institucioneve në varësi funksionale të pjesëmarrës tjerë të tregut, informata në lidhje me përbërjen dhe identitetin e zotëruesve direkt dhe indirekt. Ndërsa sa i përket përshkrimit të detajuar të strukturës organizative edhe përkundër se aplikuesi e ka dorëzuar strukturën organizative, aplikuesi obligohet që të dorëzoj një arsyeshme të pranueshme për ndryshimin e numrit të stafit në raport me propozimin e parë të dorëzuar, dhe ky arsyetim duhet të dorëzohet në ZRRE para funksionalizimit të NEMO-së.
- Për përmbushjen e kërkesave ligjore të përcaktuara me Nenin 4 par. 1.5 Aplikuesi ka ofruar sqarime në lidhje me kërkesat e kësaj pike, ku ka ofruar një shpjegim të qartë në lidhje me proceset e llogarive për secilin aktivitet.



- Për përmbushjen e kërkesave ligjore të përcaktuara me Nenin 4 par. 1.6 Aplikuesi ka ofruar sqarime duke përfshirë procedurat për pjesëmarrësit e tregut të bashkuar dhe që do të përdorin shërbimet e aplikuesit të cilat nuk do të lejojnë diskriminimin e pjesëmarrësve në treg, dhe Procedurat e brendshme në lidhje me marrëveshjet operationale dhe shërbimet për pjesëmarrësit e tregut të mos jenë diskriminuese.
- Për përmbushjen e kërkesave ligjore të përcaktuara me Nenin 4 par. 1.7 Aplikuesi ka ofruar sqarime në lidhje me rregullat dhe organizimin e përshtatshëm për mbikëqyrje të tregut sipas rregullave në fuqi.
- Për përmbushjen e kërkesave ligjore të përcaktuara me Nenin 4 par. 1.8 Aplikuesi ka ofruar sqarime se ka vendosur marrëveshje të duhura për transparencë dhe konfidencialitet me pjesëmarrësit e tregut, mirëpo ka sqaruar se në momentin e lancimit të tregut të Ditës në Avancë për zonën e operimit të Kosovës, kjo marrëveshje do të nënshkruhet me KOSTT.
- Për përmbushjen e kërkesave ligjore të përcaktuara me Nenin 4 par. 1.9 Aplikuesi ka ofruar sqarime për sa i përket ofrimit të shërbimeve të nevojshme të likuidimit dhe barazimit, ka sqaruar se ka kapital të mjaftueshëm dhe siguri financiare së bashku me procedurat për të siguruar garanci të kënaqshme për barazimet, të nevojshme për të shlyer dhe likuiduar shkëmbimin e energjisë që rezulton nga bashkimi tregut një-ditë-para dhe/ose ndërditor. Si dhe ka ofruar dëshmitë në lidhje me Marrëveshjet teknike, operationale dhe kontraktuale për të shlyer dhe likuiduar shkëmbimin e energjisë elektrike, që rezulton nga bashkimi i tregut një-ditë-para dhe/ose ndërditor, të cilat disa nga to janë finalizuar ndërsa disa tjera janë në fazën e hartimit të tyre dhe do të finalizohet para se të funksionalizimet NEMO.
- Për përmbushjen e kërkesave ligjore të përcaktuara me Nenin 4 par. 1.10 Aplikuesi ka ofruar sqarime në lidhje me veprimet e ndërmarra sa i përket sistemeve të nevojshme të komunikimit dhe praktikave të koordinimit me KOSTT sh.a.
- ZRRE ka vlerësuar se janë plotësuar kërkesat e vendosura sipas Shtojcave të Rregullës Nr. 04/2020, ku pas shqyrtimit dhe vlerësimit administrativ të aplikacionit të shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX sh.a.), për tu emëruar Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për kryerjen e aktiviteteve të ndërlidhura me bashkimin e tregut një-ditë-para dhe ndër-ditor dhe operimin e tregut të bashkuar, është propozuar që pas shqyrtimit dhe vlerësimit nga Bordi i ZRRE, të vendoset që të aprovet kërkesa duke obliguar aplikuesin që ti plotësoj edhe kërkesa e cekura nën dispozitivin II, III dhe IV të këtij Vendimi.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit dhe vlerësimit të Kërkesës për Emërimin e ALPEX SH.A., si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për kryerjen e Aktiviteteve të Ndërlidhura me Bashkimin e Tregut të një ditë para dhe ndërditor dhe Operimin e Tregut të Bashkuar për territorin e Republikës së Kosovës, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VI. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.




VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit dhe do ta njoftoj ECRB.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, anëtar


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- KOSTT sh.a,
- Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë (ECRB), dhe
- Arkivit të ZRRE-së.